



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 164, Datë 20.06.2022

MBI

TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË SHOQËRISË “HERA”SH.P.K., NR. 49, SERIA NPM07P, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR. 61, DATË 02.11.2007, “PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË (PROJEKTI KAPPET)”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13; 17 pikat 1, 2 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizime dhe Mbikëqyrjes, me nr. 925/1 prot., datë 14.06.2022 “Mbi transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., me nr. 49 Seria NPM07P, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet instaluar 150 MW, për një afat 30 vjeçar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 240, datë 02.12.2021, vendosi:
 1. Të fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., me nr. 49, Seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet të instaluar 150 MW, për një afat 30 vjeçar.
 2. Vendimi përfundimtar për transferimin e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. do të merret pasi Bordi i ERE-s të jetë shprehur në lidhje me shtyrjen ose jo të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar.
- Në lidhje me pikën 2 të dispozitivit sipërcituar, bordi i ERE-s me vendimin nr. 250, datë 13.12.2021, vendosi ndër të tjera:
 1. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.1, 3.2 dhe pikën 4, gërma “a” dhe “b” (Leja e Mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës.

Në këto rrethana vlerësojmë që transferimi i licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “HERA” sh.p.k. tek shoqëria “SOT – AL” sh.p.k., t’i nënshtrohet vendimmarrjes së bordit të ERE-s.

- Në vijim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 240/2021 për fillimin e procedurës së transferimit të licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., me nr. 49, Seria NPM07P, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, me shkresën nr. 6/27 prot., datë 02.12.2021, u bë njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 17.12.2021), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Pas vendimmarrjes së bordit të ERE-s për fillimin e procedurës për transferimin e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., midis ERE-s dhe shoqërisë kanë vijuar korrespondencat nëpërmjet shkresave:
 - Me shkresën nr. 1083/2 prot., datë 07.12.2021, ERE i është drejtuar shoqërive “HERA” sh.p.k. dhe “SOT – AL” sh.p.k. me “Njoftim vendimi” dhe ka kërkuar që në vijim të parashikimit të nenit 17, pika 5 të rregullores, duhet të paraqesë në ERE një aplikim sipas pikës 2 të nenit 17 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
 - Shoqëria “SOT – AL” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1083/3 prot., datë 30.12.2021 dhe shkresën nr. 3/3 prot., datë 21.01.2022, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar.
 - Shoqëria “HERA” sh.p.k. me shkresën nr. 44 prot., datë 17.01.2021, protokolluar në ERE me nr. 65/1 prot., datë 19.01.2022, ka përcjellë në ERE, Formatin e Aplikimit të saktësuar.
 - ERE iu drejtua shoqërisë me e-mailin zyrtar të datës 16.03.2022, për plotësime shtesë.
 - Shoqëria ka depozituar dokumentacionin shtesë me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 65/5 prot., datë 18.03.2022; nr. 65/6 prot., datë 18.03.2022 dhe nr. 65/7 prot., datë 18.03.2022.
 - ERE me vendimin nr. 48, datë 23.03.2022 vendosi të shtyjë me 30 ditë pune vendimmarrjen e saj përfundimtare për kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës, për të marrë kohën e mjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar me shkresat e sipërcituara.
 - Shoqëria u njoftua për vendimmarrjen e bordit të ERE-s me shkresën nr. 65/9 prot., datë 09.03.2022.
 - Bordi i ERE-s me vendimin nr. 103, datë 09.05.2022, i ndryshuar, vendosi të shtyjë me 30 ditë punë vendimmarrjen finale për këtë transferim, me arsye sqarimin e çështjeve që lidhen me rregullimin e pronësisë dhe financimin e projektit KAPPET.
 - ERE iu drejtua shoqërive “HERA” sh.p.k. dhe “SOT – AL” sh.p.k. me shkresën nr. 65/12 prot., datë 13.05.2022 duke i njoftuar shtyrjen e afatit të ERE-s për t’u shprehur për transferimin e plotë të licencës si dhe duke i ftuar për pjesëmarrje në seancën dëgjimore të datës 19.05.2022, për të diskutuar konkretisht çështjet që lidhen me rregullimin e pronësisë dhe financimin e projektit KAPPET.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi rezultoi i plotësuar sipas kërkesave të nenit 17, pikat 1, 2 dhe 4 e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Për sa më sipër vlerësojmë që shoqërisë “SOT – AL” sh.p.k. t’i transferohet licenca nr. 49, Seria NPM07P, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, në mënyrë që t’i jepet mundësia për të plotësuar kushtet e mësipërme brenda afatit të përcaktuar nga bordi i ERE-s në vendimin nr. 250, datë 13.12.2021 i cili ka vendosur, të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.1, 3.2 dhe pikën 4, gërma “a” dhe “b” (Leja e Mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës), afat i cili përfundon në datën 13.09.2022.

- Së bashku me licencën nr. 49, Seria NPM07P, transferohen tek shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. edhe të drejtat dhe detyrimet që shoqëria “HERA” sh.p.k. ka në kuptim të kësaj licence dhe vendimit nr. 250, datë 13.12.2021, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar”, i cili ka shtyrë me 9 (nëntë muaj) afatin e plotësimit të kushteve respektive të licencimit.
- Shoqëritë “HERA” sh.p.k. dhe “SOT-AL” sh.p.k. kanë kryer pagesën e aplikimit për transferimin e licencës në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., me nr. 49 Seria NPM07P, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet të instaluar 150 MW, për një afat 30 vjeçar, me kushtin që shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. të plotësojë kushtet e vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar brenda datës 13.09.2022.
2. Së bashku me licencën nr. 49 Seria NPM07P, transferohen tek shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. edhe të drejtat dhe detyrimet që shoqëria “HERA” sh.p.k. ka në kuptim të kësaj licence dhe vendimit nr. 250, datë 13.12.2021 “Mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar”, i cili ka shtyrë deri në datën 13.09.2022 afatin e plotësimit të kushteve respektive të licencimit, dhe gjithashtu detyrimin që shoqëria “SOT -AL” sh.p.k. brenda këtij afati të dokumentojë edhe mbështetjen financiare që do të sigurojë për projektin KAPPET.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI